




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE POGRADEC

Nr. 729/2 Prot.

Pogradec më 18/08/2023

Lënda: Kërkesë për shpallje publike

Drejtuar: DREJTORISË PËRGJITHSHME DOGANAVE
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT/TIRANË



Drejtuar: DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagja Fushë Mëzes, autostrada Tiranë-Durrës, km1
Qendra "Pajtoni Bussines Center" kati 5.

Në mbështetje të nenit 96 të ligjit Nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr 15 të Drejtorisë Përgjithshme të Doganave "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe te akcizës" datë 03.12.2018 si dhe referuar pikës 4 të nenit 162 të ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë"..."organi publik publikon aktin në faqen zyrtare të internetit dhe.."

Kërkojmë ju lutem shpalljen publike të vendimit të rikuperimit me forcë të borxhit doganor, për

Subjekti: "Agro Invest Korca" shpk Nipt M24215601J

Vendimi: Nr12/1 729/prot datë 15.08.2023

Detyrimi: shuma total 50.000 lekë. (Pesëdhjetë mijë lekë).


Kërkesa paraqitet e mbështetur në faktin se subjekti është lajmëruar me postë si dhe ridërguar por pa pranim.

Për vazhdimësinë e procedurave ligjore është domosdoshmëri data e shpalljes publike. (bashkëngjitur vendimi Nr 12/1 729/prot datë 15.08.2023)

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

Kryetari I Degës Doganore

Gentjan Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE POGRADEC

Nr. 729 Prot.

Pogradec më 15.08.2023

Vendim nr12/1

Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor të subjektit

Debitorit “Agro Invest Korca”shpk me Nipt M24215601J

Dega Doganës Pogradec në vendimin Nr 12 Prot.510.Datë 13.06.2023 ka vendosur shpalljen debitor dhe arkëtimin e borxhit doganor në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë lekë) në fomë penaliteti doganor që subjekti i sipërpërmendur ka ndaj Degës Doganore Pogradec.

Ky vendim nëpërmjet njoftim vendimit Nr.510/1 prot.datë 13.06.2023 i është komunikuar debitorit të mësipërm me anë të shërbimit postar në adresën, rruga nacionale Pogradec Korcë, ndërtesë private- nr pasurie 10/56 ZK 8581 Pogradec . Subjekti i cili ka marrë dijeni (pas ridërgimit) nëpërmjet shërbimit postar në datë 14.07.2023, nuk ka arkëtuar vullnetarisht borxhin doganor si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

Në këto kushte :

Vendosa

Në bazë të nenit 280 “ Vjelja e detyrueshme e borxhit” të ligjit nr.102/2014 i ndryshuar “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”,Udhëzimit nr 15 dt 03.12.2018 të Drejtorisë Përgjithshme të Doganave “Mbi evidentimin/kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve te papaguara doganore/akcizës, Nenet 511 e vijues të Kodit Procedurës Civile.

Të merren masat e nevojshme për sigurimin,garantimin e plotësimit të detyrimeve për tu paguar nga subjekti “Agro Invest Korca”shpk me Nipt M24215601J të përcaktuara në vendimin Nr 12 Prot.510.Datë 13.06.2023

Sa më sipër :

1. Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë , sendet me vlerë të cmuar, dokumente me anë të cilave bëhen pagesa, valuta të huaja të depozituara në një bankë që i përkasin debitorit ose garantuesit/ve.
2. Të sekuestrohen mallrat,pasuri te luajtshme/palujtshme , që i përkasin debitorit ose garantuesit/ve, i cili/të cilët ka/kanë detyrime kundrejt debitorit.

Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën e plotësimit të detyrimit në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë lekë) si dhe të kamatë vonesave.

Kryetari I Degës Doganore
Gentjan Berberi

